

VENDIM
Nr. 719, datë 12.10.2016

PËR MENAXHIMIN E KAPACITETEVE TË PESHKIMIT TREGTAR DHE DISA RREGULLIME TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË REGJISTRIT TË ANIJEVE TË PESHKIMIT

(ndryshuar me VKM nr. 772, datë 30.9.2020, nr. 330, datë 2.6.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 2; 101, pika 2; 119, pika 2, dhe 135, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim marrjen e masave menaxhuese, që synojnë mbrojtjen dhe konservimin e burimeve të gjallesave ujore në det dhe në bregdet. Ky vendim nuk zbatohet për aktivitetin e peshkimit në lagunat bregdetare dhe në ujërat e brendshme.

2. Termat e përdorur në ligjin nr. 64/2012, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Dalje/nxjerrje nga flota e peshkimit”, çregjistrimi përfundimtar i një anijeje peshkimi nga Regjistri i Anijeve të Peshkimit (RAP), të krijuar sipas nenit 32, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar;

b) “Hyrie në flotën e peshkimit”, regjistrimi i një anijeje peshkimi në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit (RAP), sipas specifikimeve të përcaktuara në nenin 32, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar;

c) “Kapacitet peshkimi”, aftësia e një anijeje peshkimi ose një grup anijesh peshkimi për të zënë peshk. Matja e kapacitetit të një anijeje bazohet në dy indikatorë: tonazhin e anijes GT dhe fuqinë motorike të saj në kW.

ç) “Anije akuakulture”, një anije e pajisur ekskluzivisht për mbledhjen, transportimin, trajtimin dhe/ose zbarkimin e prodhimeve të akuakulturës;

d) “Fotografi çasti”, lista e ngjarjeve të regjistruara për anijet në regjistrin e flotës së peshkimit për një periudhë të përvaktuar kobe;

dh) “Ngjarje”, hyrja ose dalja e një anijeje nga flota ose modifikimi i një prej karakteristikave të saj të renditura në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

II. RREGULLIMI I KAPACITETIT TË PESHKIMIT DHE I NUMRIT TË LEJEVE TË PESHKIMIT TREGTAR

1. Numri i lejeve të peshkimit tregtar profesional, për të gjitha format dhe llojet e këtij peshkimi, deklarohet i mbyllur. Me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e resurseve të pelagjikeve të vegjël, për anijet që janë të lejuara për të dyja format e peshkimit së bashku, tërheqëse fundore dhe tërheqëse pelagjike, subjekti i peshkimit ka të drejtë të ndryshojë lejen e peshkimit duke kaluar vetëm në rrjeta tërheqëse fundore.

1/1. Kalimi nga lejet e peshkimit për të dyja format e peshkimit, në rrjeta tërheqëse fundore dhe në rrjeta tërheqëse pelagjike, në formën e peshkimit vetëm tërheqëse fundore, bëhet nga ministria përgjegjëse për peshkimin.

1/2. Numri maksimal i lejeve të peshkimit tregtar artizanal bregdetar përcaktohet me urdhër nga ministri përgjegjës për peshkimin, në zbatim të planit të menaxhimit të peshkimit dhe të planit të zbatimit të peshkimit.

Për numrin e lejeve të peshkimit tregtar artizanal, të cilat mund të jepen në zonat e mbrojtura të kategorive IV, V dhe VI, të merret pëlqimi dhe nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

2. Të gjitha anijet e peshkimit të regjistruara në regjistrin e anijeve të peshkimit dhe të pajisura me numër regjistri (NFR), por që in ka mbaruar afati i vlefshmërisë së lejes së peshkimit dhe nuk e kanë rinovuar atë, kanë të drejtë të aplikojnë për rinovimin e lejes deri në datën 5 dhjetor 2020.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Inspektorati i Peshkimit pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, njofton, sipas procedurave të njoftimit të Kodit të Procedurave Administrative, subjektet e peshkimit, pronarët ose administratorët e tyre, të cilëve u ka përfunduar afati i vlefshmërisë, nuk e kanë rinovuar ose që nuk do të rinovojnë lejen e peshkimit për fillimin e procedurave të nxjerrjes nga flota e peshkimit të anijeve të peshkimit në pronësi ose në administrim prej tyre.

4. Në rast se subjektet e peshkimit, pronarët ose administratorët e anijeve të peshkimit, sipas pikës 2, të këtij kreu, nuk deklarojnë vullnetin për të vazhduar aktivitetin e peshkimit dhe të rinovojnë lejen e peshkimit, ministria përgjegjëse për peshkimin bën daljen përfundimtare të anijes nga flota e peshkimit dhe bën të pavlefshëm numrin e regjistrimit (NFR) të anijes së peshkimit.

5. MBZHRAU-ja njofton Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe QKB-në për nxjerrjen e anijeve nga flota e peshkimit, sipas pikës 4, të këtij kreu.

6. Një anije peshkimi e nxjerrë nga flota e peshkimit, sipas pikës 4, nuk mund të hyjë përsëri në flotë edhe në rast se ndryshon emrin, pronarin/administratorin e saj, portin e veprimtarisë etj.

7. Subjektet e peshkimit, në aplikimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për rinovimin e lejes së peshkimit, dorëzojnë edhe një kopje të lejes dhe të aktit të miratimit të jetës, në rastet kur anija ka qenë e pajisur me leje peshkimi të vlefshme.

8. Shfuqizuar.

9. Me mbylljen e numrit të lejeve të peshkimit tregtar profesional dhe artizanal, pas datës 5 dhjetor 2020, ministria përgjegjëse për peshkimin njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila refuzon kërkesën e subjekteve të peshkimit për hyrjen e anijeve të peshkimit tregtar profesional, përveç rastit të parashikuar në pikën 10, të këtij kreu.

10. Hyrja në flotën e peshkimit e një kapaciteti të ri peshkimi bëhet vetëm si zëvendësim me një anije me tonazh dhe fuqi motorike më të vogël ose të barabartë i një anijeje me leje të vlefshme peshkimi ose si zëvendësim i një anijeje peshkimi të mbytur, e cila ishte e pajisur me një leje të vlefshme peshkimi. Në këtë rast, subjekti i peshkimit të anijes së mbytur, pronari ose trashëgimtarët e tij aplikojnë për t'u pajisur me leje të re peshkimi.

10/1. Në aktin e miratimit të lejes së re të peshkimit, për anijen e peshkimit zëvendësuese vendoset një numër regjistrimi (NFR) i ri duke u specifikuar qartësisht që është zëvendësim i anijes me numrin e regjistrimit (NFR) të mëparshëm. Anija zëvendësuese nuk konsiderohet si hyrje e re në peshkim.

11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi ndalohet hyrja në flotën e peshkimit të mjeteve lundruese që përdorin trata tërheqëse fundore (trata koçe) me moshë më të madhe se 20 vjet.

II/I REGJISTRI I ANIJEVE TË PESHKIMIT

1. Regjistri i anijeve të peshkimit (në vijim, RAP-i) krijohet, administrohet dhe përditësohet nga drejtoria përgjegjëse për peshkimin.

2. Në RAP regjistrohen të gjitha anijet e peshkimit të përdorura për peshkim tregtar, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me përjashtim të anijeve të akuakulturës.

3. Regjistrimi në RAP bëhet kryesisht nga drejtoria përgjegjëse për peshkimin në momentin e lëshimit të aktit të miratimit të lejes së peshkimit.

4. Refuzimi i pajisjes me leje peshkimi sjell rrjedhimisht mosregjistrimin e anijes së peshkimit në regjistr.

5. Të dhënat që përmban RAP-i janë të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Regjistri duhet të mundësojë krijimin e një fotografie çasti në mënyrë automatike.

7. RAP-i është një regjistr publik, i aksesueshëm elektronikisht nga çdo person, në përputhje me pikën 8, të këtij kreu, në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për peshkimin ose në një faqe të posaçme interneti dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale.

8. Publiku ka qasje të RAP-it për të dhënat e përcaktuara në shtojcën 1, të këtij vendimi, me përjashtim të të dhënave të përfshira "për kategorinë/pronari ligjor" dhe "për kategorinë /përdoruesi.

III. TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Shtojca 1

(shtuar me VKM nr. 330, datë 2.6.2021)

Përcaktimi i të dhënave dhe përshkrimi i një regjistrimi

Emërtimi i të dhënës	Përkufizimi dhe komente	E detyrueshme (C)/ e detyrueshme nëse ka (CIF)/ fakultative (O)
NFR	Numër unik identifikimi i një anijeje peshkimi, sipas pikës 50, të nenit 4, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar. Kodi ISO-3 i shtetit, i ndjekur nga një varg identifikimi (nëntë karaktere). Një varg me më pak se 9 karaktere duhet të plotësohet me zero në të majtë.	C
UVI	(<i>Unique Vessel Identifier</i>) Identifikuesi unik i anijes (numri IMO), në përputhje me pikën 1, të nenit 20, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe urdhrin nr. 499, datë 10.9.2019, “Për zbatimin e rezolutës të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun nr. GFCM/41/2017/6, për aplikimin e numrit IMO”.	CIF
Ngjarje	Kodi – identifikon llojin e ngjarjes së raportuar.	C
Data e ngjarjes	Data në të cilën ka ndodhur ngjarja.	C
Numri i regjistrimit	Numri i regjistrimit i caktuar në regjistrin detar.	O
Shënimi i jashtëm	Sipas kreut III, të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar.	CIF
Emri i anijes	Emri i anijes së peshkimit të regjistruar në regjistrin kombëtar.	C

Vendi i regjistrimit	Kodi i identifikimit të vendit (zakonisht një port), ku është regjistruar anija.	CIF
IRCS	<i>(International radio call sign)</i> Shenja ndërkombëtare radio e thirrjes, sipas pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.	CIF
Treguesi IRCS	Anija që mbart radio ndërkombëtare - kodi.	C
Treguesi i lejes	Anija që zotëron një leje peshkimi, në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar - kodi.	CIF
Treguesi VMS	<i>(Vessel Monitoring System)</i> Sistemi satelitor i monitorimit të anijeve - kodi. Anije e pajisur me një sistem satelitor monitorimi të anijeve sipas nenit 72, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe kreut IV, të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar.	CIF
Treguesi ERS	<i>(Electronic Reporting System)</i> Anije e pajisur me një sistem elektronik të transmetimit të të dhënave (ditar regjistri), sipas nenit 77, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar - kodi.	CIF
Treguesi AIS	<i>(Automatic Identification System)</i> Anije e pajisur me sistem identifikimi automatik, sipas pikës 82, të nenit 4, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar - kodi.	CIF
MMSI	<i>(Maritime Mobile Service Identity)</i> Identifikuesi i shërbimit radio mobil detar.	O
Lloji i anijes	Sipas klasifikimit ndërkombëtar të standardizuar statistikor të anijeve të peshkimit, shtojca 6, e vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar - kodi.	CIF
Mjeti i peshkimit kryesor	Sipas klasifikimit ndërkombëtar të standardizuar statistikor të anijeve të peshkimit, shtojca 6, e vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar - kodi.	C

Mjeti i peshkimit dytësor	Sipas klasifikimit ndërkombëtar të standardizuar statistikor të anijeve të peshkimit shtojca 6, e vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar - kodi.	C
LOA	<i>(Length Over All)</i> Gjatësia e përgjithshme në metra e anijes, e përcaktuar, sipas pikës 19, të nenit 4, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.	CIF
LBP	<i>(Length Between Perpendiculars)</i> Gjatësia midis pinguleve në metra, e përcaktuar sipas pikës 20, të nenit 4, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.	CIF
Pesha GT	Pesha e përcaktuar në GT, sipas Konventës Ndërkombëtare të Londrës, 1969.	CIF
Pesha tjetër	Pesha e përcaktuar në ton, sipas Konventës Ndërkombëtare të Londrës, 1969.	CIF
GTs	Në GT, rritja e tonazhit të autorizuar për arsye sigurie (të dhëna historike).	CIF
Fuqia e motorit kryesor	E përcaktuar në kW, sipas pikës 18, të nenit 4, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.	C
Fuqia e motorit ndihmës	E përcaktuar në kW, e cila përfshin të gjithë fuqinë e instaluar të motorit që nuk përfshihet në zërin “Fuqia e motorit kryesor”.	C
Materiali i anijes	Materiali i anijes - kodi.	C
Data e hyrjes në peshkim	Hyrja në flotën e peshkimit sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi.	C
Segmenti i flotës	Kodi.	C
Vendi i importimit/eksporti mit	Kodi.	CIF
Lloji i eksportit	Kodi.	CIF
Ndihmë publike	Kodi.	CIF
Data e ndërtimit	Data e fillimit të ndërtimit.	CIF

Për kategorinë/pronari ligjor	Emri	Personi fizik: mbiemri dhe emri Person juridik: emërtimi	CIF
	Treguesi i personit juridik	“Y” për një person juridik, “N” për një person fizik - kod	O
	Rruga	Emri i rrugës dhe numri i shtëpisë	CIF
	KP	Kutia postare	O
	Qyteti	Emri i qytetit	O
	Kodi postar	Kodi postar	O
	Shteti	Shteti - kodi	O
	Numri i telefonit	Numri i telefonit (me prefiks ndërkombëtar)	O
	Numri i faksit	Numri i faksit (me prefiks ndërkombëtar)	O
	Adresa e <i>e-mail</i> -it	Adresa e <i>e-mail</i> -it	O
	Kombësia	Kombësia - kodi	O
	Identifikimi i NIPT-it të kompanisë	Numri unik i identifikimit NIPT, i ndërmarrjes dhe i pronarit të regjistruar ligjor	O
Për kategorinë /përdoruesi	Emri	Personi fizik: mbiemri dhe emri Person juridik: emërtimi	CIF
	Treguesi i personit juridik	“Y” për një person juridik, “N” për një person fizik - kod	O
	Rruga	Emri i rrugës dhe numri i shtëpisë	CIF

	KP	Kutia postare	O
	Qyteti	Emri i qytetit	O
	Kodi postar	Kodi postar	O
	Shteti	Shteti - kodi	O
	Numri i telefonit	Numri i telefonit (me prefiks ndërkombëtar)	O
	Numri i faksit	Numri i faksit (me prefiks ndërkombëtar)	O
	Adresa e <i>e-mail</i> -it	Adresa e <i>e-mail</i> -it	O
	Kombësia	Kombësia - kodi	O
	Identifikimi i NIPT-it të kompanisë	Numri unik i identifikimit NIPT, i ndërmarrjes dhe i pronarit të regjistruar ligjor	O